



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
KESHILLI I BASHKISE DEVOLL**

VENDIM

Nr 42 .Datë 29.07 .2024

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PARAPRAK PËR IMPLEMENTIMIN E KATËR LERAVE DHE
1.2 HA PYLLËZIME NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR TË BASHKISË DEVOLL.**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"(i ndyshuar), neni 21 të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" (i ndryshuar), të Ligjit Nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar), të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), në nenin 12 , 13 ,16,17 dhe në pikën 4, neni 31, të Ligjit nr.57.2020 . Vendim nr. 398, datë 13.5.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive"

VENDOSI:

- 1.Dhënien e pëlqimit paraprak për implementimit në fondin pyjor dhe kullosor të 4 (katër) lerave "ujëmbledhës" dhe projektit të pyllëzimit prej 1.2 ha të hartuara nga Sektori I Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit , referuar fitimit në fazen I të këtij projekti , pranë Komisionit European dhe IPA III .
- 2.Aplikimi ka qëllim përfitimim e fondeve për realizimin e plotë të tyre . Shpenzimet për ndërtimin e lerave dhe pyllëzimit do të mbulohen me kosto 100% nga projekti .Këto investime do të jenë shumë të dobishme të zonën përreth dhe pyllëzimi do të shërbeje për rritjen e masës në gjelbër në zonë dhe rekreacion .
- 3.Për zbatimin e tij ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit .
- 4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë sipas përcaktimeve në nenin 55 , të Ligjit Nr.139/2015" Për vetqeverisjen vendore"(I ndyshuar)

Këshilli I Bashkisë Devoll miratoi vendimin me 12 vota pro, 0 kunder , 0 abstenim

Ky vendim u shpall më 30.07.2024

KRYETARI I KËSHILLIT

GENTILAKOLLARI

